



Raport Konsultativ

Shqyrtimi i nëntë i tarifave të energjisë elektrike

SHTË9 (2015-2016)

Llogaritja e Kostos së Blerjes së Energjisë me Shumicë (Viti Relevant 3)

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE me qëllim të informimit të palëve të interesit.
Raporti nuk paraqet Vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë.

09 mar2015



Përmbajtje

| | | |
|----------|---|----------|
| 1 | Pasqyrë e Çmimit të rregulluar | 3 |
| 1 | Hyrje | 5 |
| 2 | Struktura e këtij dokumenti | 6 |
| 3 | Balanca e Energjisë | 6 |
| 3.1 | Humbjet e Lejuara në Transmision | 8 |
| 3.2 | Humbjet e Lejuara në Shpërndarje | 8 |
| 4 | MAR e Gjeneratorit të Rregulluar | 8 |
| 5 | Kostoja e Blerjes së Energjisë me Shumicë (WHPC) të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (FPPE) | 8 |
| 5.1 | WHPC dhe cirkularitetet apo referencat rrethoretë dalura nga Rregullat | 9 |
| 5.2 | S-faktori dhe norma e interes për përshtatjet..... | 10 |
| 5.3 | Përshtatjet për kostot e lejuara dhe të realizuara të blerjes së energjisë për 2013..... | 10 |
| 5.1 | Çmimi i parashikuar i importit | 10 |



Përmbledhje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është aktualisht duke i zhvilluar proceset e Përshtatjes së Rregullimit dhe Azhurnimit Vjetor të të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) të Kompanive të Rregulluara në Sektorin e Energjisë Elektrike në kuadër të Shqyrtimit të Nëntë të Tarifave të Energjisë Elektrike. Si pjesë e këtij procesi, ZRRE do të azhurnojë MAR e Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (FPEE) dhe do të përshtatë MAR e Gjeneratorit të Rregulluar (KEK), Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) bazuar në vlerat e caktuara në Shqyrtimin Periodik të bërë në kuadër të SHTE7 (2013-2017).

Ky Raport Konsultativ paraqet vlerësimin e ZRRE-së të Kostos së Blerjes së Energjisë me Shumicë të FPEE. Së bashku me këtë raport, ZRRE do të publikojë vlerësimin e MAR të Gjeneratorit të Rregulluar, KOSTT, OSSH dhe FPEE.

Komentet e palëve të interesit

ZRRE beson fuqimisht se konsultimi publik qëndron në thelb të politikave efektive rregullative. Me këtë, ZRRE i jep Kompanive të Rregulluara dhe Konsumatorëve mundësinë të shqyrtojnë të dhënat dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë Raport Konsultativ, me të cilat ata mund të mos pajtohen, dhe t'i komentojnë ato duke përmirësuar gabime faktike, duke dhënë kundër-argumente apo duke ofruar të dhëna të reja të cilat ZRRE ndoshta ende nuk i ka konsideruar. Palët të cilat dëshirojnë të shprehin mendimin e tyre mbi pozicionin e ZRRE ftohen ti dorëzojnë komentet e tyre me shkrim në ero.pricing-tariffs@ero-ks.org jo më vonë se **23 mars 2015**. Përndryshe, komentet mund të dërgohen edhe me postë tek:

Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti për Tarifa dhe Çmime
Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12
Prishtinë, 10000, Kosovë

Dokumente Relevante

| | |
|--|---|
| Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së të MAR të OSSH dhe FPEE në kuadër të SHTE7 | http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/eng/Evaluation_DSO_PES_22_March_2013.pdf |
| Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së të MAR të KEK-ut në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar | http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/Vlersimi_perfundimtar_per_Gjenerim_22Mars2013.pdf |
| Raporti Konsultativ i ZRRE për Kostot e Blerjes së Energjisë me Shumicë në kuadër të SHTE8 | http://ero-ks.org/Tarifat/2014/FPEE_Kalkulimet_e_te_Hyrave_te_Lejuara_Maksimale_Raporti_Perfundimtar_SHTE8_final.pdf |
| Raporti Konsultativ i Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm nga ZRRE | http://ero-ks.org/Tarifat/2014/Raport_vleresues_shqyrtimi_i_jashtz |



| | |
|--|--|
| | akonshem_10_8_2014.pdf |
| Aplikacioni WHPC i KEDS i dorëzuar në kuadër të procesit të tretë të Përshtatjes së Rregullt (SHTE9) | |

1 Pasqyrë e Çmimit të rregulluar

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është institucioni i pavarur i cili përcakton çmimin e rregulluar për kompani të rregulluara të cilat operojnë në tregun e rregulluar të energjisë elektrike në Kosovë. Idealisht, ZRRE do të përcaktonte çmim të rregulluar vetëm për ato segmente të sektorit të energjisë elektrike të cilat janë monopole natyrale (rrjetet e Transmisionit dhe Shpërndarjes). Megjithatë, pasi që konkurrenca në Gjenerim dhe Furnizim ende nuk është zhvilluar në nivelin i cili do të prodhonte çmime konkurrenca, ZRRE i rregullon këto segmente poashtu, duke caktuar tarifa të cilat sigurojnë mbrojtje për konsumatorët për sa i përket çmimeve të caktuara në mungesë të konkurrencës.

Rregullimi i Çmimit është mjet që përdoret nga ZRRE në mënyrë që të caktohet shuma e parave (Të Hyrat e Lejuara Maksimale – MAR), të cilën Kompanitë e Rregulluara lejohen ta rimarrin për ofrimin e një shërbimit të rregulluar. MAR caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike duke analizuar hollësisht shpenzimet dhe investimet të cilat Kompanitë planifikojnë t'i bëjnë përgjatë kohës së përcaktimit të çmimit. Niveli i MAR caktohet në mënyrë që kompanitë të lejohen t'i mbulojnë kostot e arsyeshme të operimit dhe mirëmbajtjes së impianteve dhe të kenë kthim të arsyeshëm në kapital nëse i japin rezultatet e investimeve të aprovuara fillimisht. Gjithashtu, ZRRE përcakton caqe të efikasitetit, të cilat synojnë të ngrisin efikasitetin operativ të kompanive dhe të ofrojnë stimulime apo sanksione nëse kompanitë dështojnë t'i arrijnë këto caqe.

Sipas Rregullave të Çmimeve, legjislacionit sekondar të ZRRE-së që rregullon tarifën e energjisë elektrike, Kosto e Blerjes së Energjisë me Shumicë janë kosto të cilat i kthehen Furnizuesit Publik në mënyrë që të kompenzohen shpenzimet e realizuara për blerjen e energjisë elektrike për ti furnizuar konsumatorët e rregulluar. Këto kosto azhurnohen për çdo vit për vlerat e ndryshueshme hyrëse, të cilat kanë ndikim në kostot e furnizimit. Gjatë llogaritjes së Kostos të Blerjes së Energjisë me Shumicë, ZRRE i rishikon dhe i rivendos çmimet e parashikuara të importit dhe eksportit, e rivendosë /aktualizon nivelin e humbjeve të lejuara në system dhe të kostove të lidhura me ato, dhe e cakton cakun e disponueshmërisë për gjeneratorin e rregulluar bazuar në orarin e planifikuar të mirëmbajtjes dhe riparimit të impianteve dhe pajisjeve.

Tabela 1 Faktorët që ndikojnë Kostot e Blerjes së Energjisë me Shumicë në një shikim

| Kostoja e Blerjes së Energjisë me Shumicë (WHPC) | |
|--|---|
| Disponueshmëria e njësisë gjeneruese | Disponueshmëria e njësisë gjeneruese është ngritur vazhdimisht gjatë dekadës së fundit, por për shkak të ndërprerjeve të fundit të shkaktuara nga shpërthimi në Kosovën A, është imponuar një ngritje në pjesën e |



| | |
|---------------------------------|---|
| | energjisë së importuar në portofolin e konsumit. |
| Reduktimi i humbjeve në sistem | Gjatë SHTE6, ZRRE ka caktuar caqet për reduktimin e humbjeve në shpërndarje për 6 vitet e ardhshme (3 pikë përqindje për tri vitet e para dhe 2.5 pike përqindje për tri vitet tjera - 1 vit në kuadër të SHTE6 dhe 5 vite në kuadër të SHTE7). Humbjet e mbuluara nga tarifat pothuajse do të përgjysmohen (reduktim prej 16.5 pikë përqindje) deri në vitin 2017. |
| Kostot e reduktuara të importit | Çmimet e importit në kuadër të SHTE9 janë më të ulëta se ato të lejuara në kuadër të SHTE8 për shkak të rënies së çmimeve të energjisë në treg. |



1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë është aktualisht në procesin e zhvillimit të Shqyrtimit të Nëntë të Tarifave të Energjisë Elektrike për Furnizuesin Publik të Energjisë Elektrike (FPEE) dhe të Përshtatjes së Rregullt për Vitin e Tretë Relevant¹ të Shqyrtimit të Tarifave SHTE7 për Gjeneratorin e Rregulluar (KEK), Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).

Në vitin 2012/2013, ZRRE kishte zhvilluar Procesin e Shqyrtimit Periodik (SHTE7) gjatë të cilit ajo caktoi të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për pesë Vitet e ardhshme Relevante për Gjeneratorin e Rregulluar (KEK), Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). Sipas Rregullave për Çmime, një proces i Përshtatjes së Rregullt do të ndërmerret në mes të secilit Vit Relevant të Periudhës Rregullative në mënyrë që të llogaritet ndryshimi i lejuar në MAR. Procesi i Përshtatjes së Rregullt ndryshon nga ai i Shqyrtimit të plotë Periodik, në të cilin ZRRE do të ndërmerre një shqyrtim të detajuar të kostove të lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes, humbjeve të lejuara dhe faktorëve të efikasitetit dhe Programeve të Shpenzimeve Kapitale të Lejuara. Në vend të kësaj, gjatë Përshtatjeve të Rregullta, ZRRE bën vetëm përshtatjen mekanike për ndryshime në mes të vlerave të lejuara dhe të realizuara të asaj se çfarë ishte lejuar gjatë Shqyrtimeve Periodike. Gjatë këtij procesi të Përshtatjes së Rregullt, ZRRE do të:

1. Indeksujë Kostot e Lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes për të gjithë të licencuarit me Faktorin e Efikasitetit, të caktuar gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik, dhe me Inflacionin Vjetor, të caktuar duke u bazuar në Indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – për të gjitha njësitë në Eurozonë;
2. Përcaktojë Cakun e Disponueshmërisë të Gjeneratorit të Rregulluar;
3. Përcaktojë Ngarkesën e Energjisë dhe Ngarkesën e Kapacitetit të Gjeneratorit të Rregulluar;
4. Azhurnojë Kostot e Lejuara të Furnizimit me Thëngjill (LGSCt) të Gjeneratorit të Rregulluar. Ky azhurnim përfshin edhe ri-përcaktimin e Kostovetë operimit dhe mirëmbajtjes, të Zhvlerësimit dhe Fitimin e Lejuar të Minierës duke ndjekur të njëjtat principe sikur për Gjeneratorin e Rregulluar. Ri-përcaktimi i LGSCt-të do të përfshijnë ndryshimin në mes të kostove të realizuara dhe të lejuara të furnizimit me thëngjill në Vitin e parë Relevant të Periudhës Rregullative;
5. Azhurnojë Kostot e Lëndëve të Tjera Djegëse (OTFct) të Gjeneratorit të Rregulluar për të përfshirë ndryshimin në mes të kostove të realizuara dhe të lejuara në Vitin e parë Relevant të Periudhës Rregullative;
6. Llogarisë Koston e Blerjes së Energjisë me Shumicë, e cila përfshinë koston e blerjes së energjisë nga Gjeneratorët e Rregulluar, Importet dhe Marzhën me Pakicë. Këto janë të azhurnuara në mënyrë që të reflektojnë ndryshimin në mes të kostove të realizuara dhe të lejuara të blerjes së energjisë në Periudhën paraprake Rregullative;

¹ “Vit relevant” nënkupton periudhën prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm në mes të azhurnimeve vjetore



7. Caktojë Kostot e Lejuara të Humbjeve (LSSct) për Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), dhe t'i azhurnojë këto në mënyrë që të përfshijnë ndryshimin në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara të humbjeve për Periudhën paraprake Rregullative, të cilat mund të kenë lindur si rezultat i ndryshimeve në kostot e blerjes së energjisë me shumicë apo i ndryshimeve në rrjedhat e energjisë elektrike në sistemin e transmisionit;
8. Azhurnojë MAR e OST në mënyrë që të reflektojë të hyrat e gjeneruara nga Mekanizmi për kompenzim ndër-OST;
9. Azhurnojë MAR e OST në mënyrë që të reflektojë ndryshimin në mes të të Hyrave të Rregulluara të Lejuara dhe të Realizuara në Vitin paraprak Relevant (t-1);
10. Caktojë Ngarkesat për shfrytëzimin e rrjetit të sistemit të transmisionit, për Operatorin e Tregut, dhe për Operatorin e Sistemit;
11. Caktojë Koston e Lejuar të Humbjeve (LSSct) për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe t'i azhurnojë këto të përfshijnë ndryshimin në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara të humbjeve për Periudhën paraprake Rregullative, të cilat mund të kenë lindur si rezultat i ndryshimeve në koston e blerjes së energjisë me shumicë apo i ndryshimeve në rrjedhat e energjisë elektrike në sistemin e Shpërndarjes;
12. Azhurnojë MAR e OSSH në mënyrë që të reflektojë ndryshimin në mes të të Hyrave të Rregulluara të Lejuara dhe të Realizuara në Vitin paraprak Relevant (t-1);
13. Caktojë Ngarkesat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;
14. Llogarisë Koston e Lejuar të Shitjes me Pakicë të Furnizuesit të Energjisë Elektrike, e cila përfshijnë kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes të aktivitetit të FPEE, kostot e korporatës, lejitimet e zhvlerësimit dhe kosto të tjera të arsyeshme të FPEE;
15. Caktojë MAR të ri të FPEE duke përfshirë ndryshimin në mes të faturimit të lejuar dhe të realizuar në Periudhën paraprake Rregullative;
16. Caktojë Tarifa të reja me Pakicë.

2 Struktura e këtij dokumenti

Ky raport konsultativ është i organizuar si vijon:

- Pjesa 3 paraqet Balancën e Energjisë të supozuar nga ZRRE për Vitin e tretë Relevant të Periudhës Rregullative (2013-2017);
- Pjesa 4 paraqet MAR-in e Gjeneratorit të Rregulluar
- Pjesa 5 rishikon zbatimin e Kostos së Blerjes së Energjisë me Shumicë (WHPC) dhe parashtron propozimet e ZRRE-së për Koston e Lejuar të Blerjes së Energjisë me Shumicë për Periudhën e ardhshme Rregullative;

3 Balanca e Energjisë

Balanca e Energjisë e përdorur për llogaritjen e Kostos mesatare me shumicë kryesisht i referohet balancës zyrtare të energjisë të aprovuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2015². Balanca

²<http://bit.ly/17YNZn3>



e përdorur për llogaritjen e WHPC është ndërtuar duke përdorur qasje poshtë-lartë me nivelet e eksporteve të shfrytëzuara si faktor balancues në mes të ofertës dhe kërkesës brenda vendit:

- Balanca fillon nga niveli i pritur i shitjeve të parashikuara në nivel të shpërndarjes të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike në aplikacionin e tyre; ndryshe prej herëve të tjera, kur ZRRE i ishte referuar balancës së MZHE-së për parashikimin e shitjeve, kësaj rradhe ZRRE ka marrë si referencë parashikimin e KEDS pasi që balanca e MZHE-së kishte paraparë rritje të shitjeve në nivel prej 17.9% që ZRRE e konsideron tejet optimist.
- Niveli i lejuar i humbjeve nga ZRRE dhe parashikimi i prodhimit të kyçur në shpërndarje i shtohet shumës së kërkesës totale në nivel të shpërndarjes (duke përfshirë humbjet);
- Kërkesa totale në nivelin e shpërndarjes plus kërkesa në nivelin e transmisionit krahasohet me parashikimin e neto prodhimit vendor dhe importin në balancën e energjisë. Ndryshimi mbulohet nga eksportet.

Balanca e energjisë e përdorur për llogaritjen e WHPC është dhënë më poshtë:

Tabela 2 Balanca e Energjisë e përdorur për llogaritjen e Kostove të Blerjes së Energjisë me Shumicë të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike

| Balanca e Energjisë | | SHTE8 Lejuar | SHTE8 i Jashtëzak. | SHTE8 Realizuar | SHTE9 Lejuara |
|---|-----|-----------------|-----------------------|--------------------|------------------|
| Gjenerimi KEK | | 5,525.0 | 5,098.1 | 4,858.0 | 5,570.9 |
| Kosova A | GWh | 1,929.0 | 1,502.1 | 1,508.9 | 1,755.6 |
| Kosova B | GWh | 3,595.95 | 3,595.95 | 3,349.07 | 3,864.81 |
| Ko-gjenerimi | GWh | | | | -49.49 |
| Gjenerimi tjetër i kyçur në Transmision | | | | | |
| HC Ujmani | GWh | 82.0 | 82.0 | 101.5 | 84.0 |
| Kërkesa e kyçur në Transmision | | 617.1 | 617.1 | 622.9 | 723.6 |
| Konsumi i Ferronikelit | GWh | 526.7 | 526.7 | 537.0 | 632.0 |
| Trepca | GWh | 27.1 | 27.1 | 85.9 | 25.9 |
| Sharrcem | GWh | 63.3 | 63.3 | | 65.8 |
| Konsumi tjetër në nivel të Transmisionit | | 283.1 | 283.1 | 227.7 | 272.1 |
| Konsumi i minierës | GWh | 138.0 | 138.0 | 112.3 | 138.0 |
| Kosova A – furnizimi nga Transmisioni | GWh | 53.2 | 53.2 | 76.5 | 42.2 |
| Kosova B – furnizimi nga Transmisioni | GWh | 91.9 | 91.9 | 39.0 | 91.9 |
| Humbjet në Transmision | % | 1.8% | 1.8% | 1.8% | 1.8% |
| | GWh | 109.0 | 107.0 | 108.8 | 110.9 |
| Energjia që hyn në Sistemin e Transmisionit | | 6,057.2 | 5,942.7 | 5,916.4 | 6,162.9 |
| Eksportet | GWh | 599.0 | 486.5 | 451.9 | 638.3 |
| Prodhimi total | GWh | 5,607.0 | 5,180.1 | 4,959.5 | 5,654.9 |



| | | | | | |
|---|-----|---------|---------|---------|---------|
| Importet | GWh | 450.3 | 762.7 | 867.5 | 508.0 |
| Energjia e nevojshme që të arrihet ngarkesa e transmisionit | GWh | 1,608.2 | 1,493.7 | 1,411.4 | 1,744.9 |
| Energjia e nevojshme që të arrihet ngarkesa e shpërndarjes | GWh | 4,449.1 | 4,449.1 | 4,504.9 | 4,418.0 |
| Gjenerimi në shpërndarje | | | | | |
| Gjenerimi i kyçur në shpërndarje | GWh | 46.3 | 46.3 | 49.9 | 46.6 |
| Wind Power sh.a.. | GWh | | | | |
| Konsumi në shpërndarje | GWh | 4,495.4 | 4,495.4 | 4,554.8 | 4,464.6 |
| Humbjet në shpërndarje dhe energjia e pa fatuar | | | | | |
| Humbje teknike dhe komerciale | % | 25.6% | 25.6% | 30.01 | 23.1% |
| | GWh | 1,098.2 | 1,098.2 | 1,298.5 | 979.0 |
| Furnizime të pa fatuara | % | 4.69% | 4.69% | 4.99% | 5.21% |
| | GWh | 211.0 | 211.0 | 227.3 | 232.5 |
| Humbje totale | GWh | 1,309.2 | 1,309.2 | 1,525.8 | 1,211.4 |
| Shitje tek konsumatorët final | GWh | 3,186.2 | 3,186.2 | 2,029.0 | 3,253.1 |

3.1 Humbjet e Lejuara në Transmision

Niveli i Lejuar i Humbjeve në Transmision është vendosur të jetë 1.8% siç ishte përcaktuar gjatë Procesit të Shqyrtimit Periodik.

3.2 Humbjet e Lejuara në Shpërndarje

Caku i humbjes në shpërndarje është llogaritur duke zbritur 2.5% (pikë përqindje) nga caku i humbjes në shpërndarje i aplikuar ndaj humbjeve teknike dhe komerciale të caktuara në kuadër të Shqyrtimit SHTE8. Caku i humbjes është reduktuar në përputhje me Vendimin 399 të bordit të ZRRE, i cili kishte caktuar parametrat rregullativ (inputet) nxitëse për Periudhën Rregullative dhe Shqyrtimin SHTE6. Caku paraprakisht i lejuar prej 25.6% (pa e përfshirë furnizimin e pa fatuar) tani është reduktuar në 23.1%.

4 MAR-i i Gjeneratorit të Rregulluar

Llogaritja e MAR të Gjeneratorit të Rregulluar është dhënë në një raport konsultativ të veçantë. Niveli i lejuar i MAR të KEK-ut i konsideruar në kuadër të llogaritjes së WHPC është €140.2 milion.

5 Kostoja e Blerjes së Energjisë me Shumicë (WHPC) të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (FP EE)

Kjo pjesë e Raportit Konsultativ paraqet pikëpamjet e ZRRE-së në Koston e Lejuar të Blerjes së Energjisë me Shumicë (WHPC) të cilën Furnizuesi Publik i Energjisë Elektrike do të lejohet t'i rimarrë



përmes tarifave të rregulluara. Sipas Nenit 13 të Rregullës për vendosjen e Çmimeve të Energjisë Elektrike, Kostot e Blerjes së Energjisë me Shumicë përfshijnë:

- Kostot e Kapacitetit me Shumicë (WHCC) që paraqesin kostot të cilat kanë për qëllim t'i mbulojnë ngarkesat e kapacitetit nga kapacitetet gjeneruese vendore, të cilat janë të kontraktuara për të garantuar siguri të furnizimit e cila është e dedikuar për konsumatorët e rregulluar;
- Kostot e Energjisë Elektrike me Shumicë (WHEC) të cilat përbëhen nga:
 - Kostot e blerjes së energjisë elektrike nga gjenerimi vendor;
 - Kostot e importit të energjisë;
 - Kostot e eksportit të energjisë (si kosto negative), të cilat i nënshtrohen faktorit ndarës të eksportit;
 - Kostot neto të debalancit, që i nënshtrohen faktorit ndarës të debalancit.
- Marzha e Shitjes me Pakicë e cila i jep FPEE një fitim të arsyeshëm për të kompenzuar rrezikun që FPEE ndërmerr gjatë ofrimit të shërbimeve standarde për konsumatorët e rregulluar.

Faktori ndarës i eksportit tani është i përcaktuar në 100%, gjë që do të thotë se të gjitha të hyrat e eksportit të energjisë përjashtohen nga llogaritja dhe u kthehen konsumatorëve (si kosto negative). Nuk ka kosto të debalancit për momentin, kështu që llogaritjet e kostove neto të debalancit janë zero.

5.1 WHPC dhe cirkularitetet apo referencat rrethore nga Rregullat

Kostot e Energjisë me Shumicë, siç janë të definuara me Rregullën për Çmime, krijojnë një numër të referencave rrethore (cirkulariteteve), të cilat duhet të adresohen në modelimin e llogaritjeve.

Një nga këto cirkularitete shfaqet për shkak të zbritjes së të hyrave nga humbjet nga WHPC. Paragrafi 5 i Nenit 13 e Rregullës për Çmime të FPEE thotë se të hyrat e FPEE nga shitjet e humbjeve të OST dhe OSSH duhet të zbriten nga kostot e energjisë me shumicë. Megjithatë, këto të hyra janë produkt i vëllimit të humbjeve të lejuara (në GWh) dhe të kostove të ponderuara të blerjes së energjisë me shumicë (WHEA – shprehur në €/MWh). Kjo e fundit varet nga kostot e blerjes së energjisë me shumicë, e cila varet nga të hyrat e FPEE nga humbjet. Kjo paraqet një çështje qarkimi pasi që të hyrat e humbjeve varen nga WHPC dhe anasjelltas.

Një reference rrethore tjetër lind nga fakti se të hyrat e Gjeneratorit të Rregulluar (pjesë e WHEC komponentës të WHPC) përfshijnë kostot e ngarkesave të Operatorit të Sistemit (OS), të cilat paguhet nga Gjeneratori i Rregulluar. Ngarkesat e OS varen nga humbjet në transmision, dhe këto varen nga Kostot e Ponderuara të Blerjes së Energjisë me Shumicë (WHEA), të cilat varen nga Kostot e Blerjes së Energjisë, të cilat varen nga të Hyrat e Gjeneratorit të Rregulluar, duke përfshirë Ngarkesat e OS. Kjo paraqet një qarkim të mëtejshëm.

Në llogaritjen e WHPC të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike në kuadër të Shqyrtimit SHTE9, ZRRE ka adoptuar të njëjtën qasje sikur në SHTE8.



5.2 S-faktori dhe norma e interes për përshtatjet

Sipas Shtojcës 1 të Artikullit 2.1 të Rregullës për Çmime të FPEE, norma e interesit e aplikueshme në MAR të FPEE në cilin do Vit Relevant është e llogaritur duke u bazuar në EURIBOR plus S%, ku S është vlerë e përcaktuar nga ZRRE gjatë Azhurnimeve Vjetore dhe që reflekton premiumin e pagueshëm nga i licencuari për huatë afatshkurtra. Kjo ndryshon nga principi i aplikuar në Rregullat e tjera të Çmimeve³ ku vlera S caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike dhe mbahet konstante përgjatë Periudhës Rregullative.

ZRRE ka ricaktuar vlerën S për përshtatjet e Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike si në vijim:

Normat për Kredi (huadhënie) të Kosovës është marrë nga Buletini Mujor Statistikor i Bankës Qendrore të Kosovës, Tabela 14.2 (Normat efektive të interesit të KTD-ve – normat në kredi)⁴. Vlera e marrë është për norma të kredive afariste investuese për kredi deri në 1 vit.

Norma finale e interesit për përshtatje është vlera për dhjetor 2014 (10.8%) minus EURIBOR për dhjetor 2014 (0.330%⁵ – EURIBOR 1-vjeçar për dhjetor 2014) + 0.252% (norma aktuale e EURIBOR⁶) = 10.72%.

5.3 Përshtatjet për kostot e lejuara dhe të realizuara të blerjes së energjisë për 2013

Gjatë secilit Azhurnim Vjetor, ZRRE i përshtat Kostot e Blerjes së Energjisë me Shumicë të FPEE për ndryshime në mes të kostove të energjisë të parashikuara dhe të realizuara në vitin paraprak. Kostot totale të blerjes së energjisë të lejuara në 2015 pas Përshtatjes së Jashtëzakonshme ishin €169.1 milion, ndërsa ato të realizuara nga FPEE ishin €162.1 milion. Ndryshimi prej -€6.9 milion kthehet prapa me normën e aplikuar të interesit siç është e specifikuar në Paragrafin 2.2 të Shtojcës 1 të Rregullës për Çmime të FPEE.

5.1 Çmimi i parashikuar i importit

Çmimi mesatar i importit i paguar nga KEDS ishte me i ulët sesa çmimi i supozuar nga ZRRE gjatë përshtatjeve të SHTE8 dhe Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm. Çmimet e realizuara të importit dhe eksportit janë dhënë në tabelën më poshtë:

³Domethënë Rregulla për Çmime të Gjenerimit, Transmisionit dhe Shpërndarjes


⁴<http://bqk-kos.org/repository/docs/2015/BQK-BMS%20nr%20160.pdf>

⁵<http://www.euribor-rates.eu/euribor-rate-12-months.asp>

⁶Norma Euribor për 19 shkurt 2015 (<http://www.euribor-rates.eu/euribor-rate-12-months.asp>)



Figura 1 Vëllimet dhe çmimet e realizuara të importit dhe eksportit në 2015



Çmimi i parashikuar i importit për vitin 2015 është vlerësuar duke përdorur ndryshimet në çmimet e ardhshme të Tregun European të Energjisë në mes të vitit 2014 dhe 2015 dhe duke e aplikuar këtë në çmimin real të importit në vitin 2014 të paguar nga KEDS. Trendi është llogaritur duke përdorur kontratat nga "Phelix Peak load Futures", të cilat reflektojnë çmimin e parashikuar të energjisë në Gjermani, Austri dhe pjesët e mëdha të Europës. Kontratat nga "Phelix Peak load Futures" tregtohen në Tregun European të Energjisë (EEX) dhe llogariten në baza ditore si çmimi mesatar për ngarkesën e pikut të energjisë elektrike të tregtuar në EEX. Kontratat me datë të maturimit të një kuartali për katër kuartalët në vitin 2014 dhe 2015 janë përdorur dhe çmimi i marrë është çmimi i kontratës në ditën e fundit të tregtimit. Bazuar në këtë princip, ZRRE propozon një çmim mesatar të importit prej 55 €/MWh për vitin 2015.



Tabela 3 Kostot e Blerjes së Energjisë me Shumicë (WHPC) – përmbledhje e llogaritjeve

| Kostot e Blerjes së Energjisë me Shumicë | | SHTE8 Lejuar | SHTE8 Shqyrtim | SHTE8 Realizuar | SHTE9 Propozuar |
|--|--------------|-----------------|-------------------|--------------------|--------------------|
| Gjenerimi vendor | | | | | |
| Gjenerimi KEK | €/MWh | 25.3 | 25.3 | 25.2 | 26.47 |
| | €000s | 139,535 | 128,754 | 122,188 | 140,277 |
| HC Ujmani | €/MWh | 27.5 | 27.5 | 27.5 | 27.5 |
| | €000s | 2,255 | 2,255 | 2,584 | 2,310 |
| Gjenerimi i kyçur në shpërndarje (mesatarja) | €/MWh | 43.8 | 43.8 | 43.8 | 43.8 |
| | €000s | 2,028 | 2,028 | 2,028 | 2,041 |
| Importet | | | | | |
| Importet e kontraktuara | GWh | 450.3 | 762.7 | 867.5 | 508.0 |
| | €/MWh | 60.0 | 60.0 | 52.5 | 55.0 |
| | €000s | 27,017 | 45,760 | 45,509 | 27,938 |
| Eksportet | | | | | |
| Eksportet e kontraktuara | GWh | 599.0 | 486.5 | 451.9 | 638.3 |
| | €/MWh | 30.0 | 30.0 | 32.9 | 30.8 |
| | €000s | 17,970 | 14,596 | 14,851 | 19,661 |
| Kostot e Blerjes së Energjisë | | | | | |
| Gjenerimi KEK | €000s | 139,535 | 128,754 | 122,188 | 140,277 |
| Gjenerimi tjetër vendor | €000s | 4,283 | 4,283 | 4,612 | 4,351 |
| Importet | €000s | 27,017 | 45,760 | 45,509 | 27,938 |
| Kostot totale të Blerjes së Energjisë | €000s | 170,835 | 178,797 | 172,309 | 172,565 |
| Eksportet | €000s | -17,970 | -14,596 | -14,851 | -19,661 |
| Subvencionet | €000s | 0 | 0 | 0 | 0 |
| WHEC + WHCC | €000s | 152,865 | 164,201 | 157,458 | 152,905 |
| Marzha me pakicë | | | | | |
| Marzha me pakicë | % | 3% | 3% | 3% | 3% |
| Kosto e marzhës me pakicë | €000s | 4,586 | 4,926 | 4,724 | 4,587 |
| WHPC | | | | | |
| WHPCat-1 - WHPCft-1 | €000s | -13,384.0 | -13,384.0 | 0 | -6,944.8 |
| It | % | 13.14% | 13.14% | 0 | 10.72% |
| (WHPCat-1 - WHPCft-1)*(1+It) | €000s | -15,142.8 | -15,142.8 | 0 | -7,857.4 |
| WHPCf | €000s | 142,309 | 153,984 | 162,182 | 149,634 |
| Kostoja mesatare e ponderuar e energjisë (WHEA) | | | | | |
| | €/MWh | 27.3 | 29.5 | 31.2 | 28.2 |